

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Spitali i Përgjithshëm, Prizren, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Pëlqim Mjedisor, për trajtimin e mbetjeve spitalore në Spitalin e Prizrenit.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 14.04.2026 në ora 11:00 në Zyrën e Telemjekësisë Nr.101, kati I, Objekti Spitalor Nr. II (Objekti i Emergjencës), Spitali i Përgjithshëm, Prizren, do të organizohet debat publik nga Spitali i Përgjithshëm, Prizren në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën online:

<https://us05web.zoom.us/j/6421657817?pwd=rb2LnLbKdjf7MboegmYadbV1vDXVnK.1>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë Spitali i Përgjithshëm, Prizren, për Pëlqim Mjedisor, për trajtimin e mbetjeve spitalore në Spitalin e Prizrenit.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin

vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.



**RAPORT I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS
INSENERATORI - IMPIANTI
PËR
TRAJTIMIN E MBETJEVE SPITALORE NË SPIATALIN
E PRIZRENIT**



INVESTITOR: SPITALI REGJIONAL - PRIZREN

ADRESA: Shesh Emini

Shtator 2025



Contents

1. HYRJE.....	4
2. BAZA LIGJORE PËR HARTIMIN E RAPORTIT	5
2.1. Rregullativa ligjore e vlerësimit të ndikimit në mjedis – VNM	5
2.2. Metodologjia e punës	6
2.3. Metodologjia e përgjithshme.....	7
3. PËRSHKRIMI I LOKACIONIT DHE MJEDISIT	10
3.1. Potencialet ekzistuese	10
3.2. Pozita gjeografike e komunes së Prizrenit.....	10
3.3. Pozita gjeografike e lokacionit.....	10
3.4. Popullsia	11
3.4. Infrastruktura ekzistuese	12
3.5. Ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore.....	12
3.6. Flora dhe Fauna	13
3.7. Kushtet klimatike	13
3.8. Ajri	13
4. PËRSHKRIMI I PAISJES DHE PROCESIT	15
4.1. Përshkrimi i objektit.....	15
4.2. Përshkrimi i paisjes	18
4.3. Procesi i Riciklimit	20
5. VLERËSIMI I NDIKIMIT NË MJEDIS	29
5.1. Ndotja e ajrit.....	29
5.2. Ndotja e ujit	30
5.3. Ndotja e tokës.....	31
5.4. Zhurma.....	31
5.5. Ndikimet në florë dhe faunë.....	31
5.6. Ndikimi në mjedis në rastet aksidentale	32
6. PËRSHKRIMI I MASAVE PËR ZVOGËLIMIN E NDIKIMEVE NEGATIVE NË MJEDIS	33
6.1. Masat për mbrojtjen e ajrit	34
6.2. Masat për mbrojtjen e ujit dhe tokës.....	34
6.2.1. Masat për mbrojtjen e ujit	35
6.2.2. Masat e marura për mbrojtjen e tokës.....	36
6.3. Masat që duhet të merren në rastet aksidentale	36
6.4. Rekomandimet tjera për evitimin e ndikimeve negative	37



7.	MARJA E MASAVE REHABILITUESE PAS PËRFUNDIMIT TË PROJEKTIT.....	39
8.	PËRFUNDIM	40

Lista e figurave:

Figure 1. Lokacioni i objektit.	11
Figure 2. Foto nga tereni.	11
Figure 3. Lokacioni i objektit.	12
Figure 4. Skema e procesit teknologjik.	15
Figure 5. Fotot e marra nga tereni, si dhe skicat e detajuara të pajisjes.	20
Figure 6. Në foto shembulli i ciklit të trajtimit.	22
Figure 7. Paraqitja grafike e ciklit të sterilizimit.	27
Figure 8. Paraqitja skematike e procesit teknologjik.	27
Figure 9. Foton nga teren – grumbullimi i mbetjeve spitalore.	30
Figure 10. Ndikimet pozitive në mjedis nga ky proces teknologjik.	33



1. HYRJE

Spitali i Prizrenit është një institucion spitalor regjional i rrethinës së Prizrenit. Si cdo objekt spitalor edhe në këtë institucion zhvillohen aktivitete të ndryshme të shërbimeve mjeksore marr parasysh që spitali i Prizrenit ka në strukturën e tij reparte të rëndësishme, ku kryhen shërbime nga trajtimet e lehta deri te interevimet kirurgjike te natyrave të ndryshme. Pa dyshim që gjatë zhvillimit të aktiviteteve dhe kryerjes së shërbimeve krijohen mbetje dhe mbeturina të ndryshme.

Mbetjet në përgjithësi kategorizohen ne bazë të përmbajtjes si mbetje te rrezikshme dhe ato te parrezikshme, pikerisht ne baze te tyre edhe duhet te klasifikohen-ndahen dhe trajtohen.

Për këtë qëllim Spitali i Prizrenit ka ndërtuar objektin e veqant në të cilin edhe ka vendosur paisjen adekuate për trajtimin e mbetjeve spitalore e quajtur Insenerator.

Për marrjen e Lejes Mjedisore Komunale për paisjen – Inseneratorin një Impiant për trajtimin e mbetjeve spitalore ne Spitalin e Prizrenit, kemi bërë përgatitjen e dokumentacionit të kërkuar dhe të nevojshëm për hartimin e raportit për vlersimin e ndikimit në mjedis.

Me këtë raport janë identifikuar dhe analizuar ndikimet mjedisore qe mund të vijnë nga ky projekt, ku janë marrë për bazë karakteristikat e gjendjes ekzistuese te mjedisit ne lokalitetin e këtij projekti si dhe karakteristikat e potencialeve natyrore përkatëse inxhinjero-teknike te punëve te cilat zhvillohen ne baze te projektit nga ana tjetër.

Nga kjo vjen nevoja që me anë të raportit për vlerësim të ndikimit ne mjedis, të përkufizohen te gjitha ndikimet relevante qe mund te paraqiten ne relacionin e objektit përkaes - mjedist. **Duke u nisur nga qëllimi paraprak dhe ne metodologjinë e hartimit te VNM-së, ky raport behet me qellim te identifikimit te ndikimeve potenciale dhe caktimin e masave te cilat do te jene te nevojshme për tu marre për mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet negative.**

Raporti për VNM po ashtu i referohet ligjeve dhe rregulloreve ekzistuese ne infrastrukturën ligjore ne Kosovë. Sipas legjislacionit kosovar (Ligji i Vlerësimit te ndikimit ne Mjedis Ligji Nr. 08/L-181) .

Ndonëse aktivitetet e projektit ne mjedis nuk priten te gjenerojnë efekte te mëdha dhe te pa kthyeshme negative, megjithatë ato ne vetvete mund te mbartin efekte mjedisore te cilat duhet te vihen në konsiderate.



2. BAZA LIGJORE PËR HARTIMIN E RAPORTIT

Raport i VNM-së përfshin identifikimin e masave mbrojtëse për mjedisin me rastin e ndonjë aksidenti ambiental gjatë funksionimit të vazhdueshëm të “Inseneratorit – Impiantit për trajtimin e mbetjeve spitalore në Spitalin e Prizrenit” identifikimin e burimit që rrezikon mjedisin.

- vlerësimin e ndikimit në mjedis
- propozimin e masave themelore për minimizimin apo zvogëlimin e ndikimeve negative deri në një kufijtë e lejuar.

2.1. Rregullativa ligjore e vlerësimit e ndikimit në mjedis – VNM

Në lidhje me vlerësimin e ndikimit në mjedis – VNM është aprovuar dhe funksionon Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 08/L-181 i cili përcakton të gjitha procedurat për përgaditjen për miratimin të VNM.

Ligjet me të rëndësishme të aplikuara për hartimin e VNM-së për projektin janë si me poshtë:

- Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025
- Ligji për VNM Nr. 08/L-181
- Ligji për tokën bujqësore Nr. 02/L- 26
- Ligji nr. 08/l-262 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që përmbajnë procedura të veçanta administrative dhe harmonizimin e tyre me ligjin nr. 05/l-031 për procedurën e përgjithshme administrative faza e dytë.
- Ligji për mbrojtjen e natyrës Nr. 03/L-233
- Ligji për ujërat e Kosovës Nr. 04/L-147
- Ligji për mbrojtjen e ajrit Nr. 08/L- 025
- Ligji nr. 08/l-071 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.04/l-060 për mbeturina
- Ligji për Mbeturina shtojca Nr. 04/L-060
- Ligji nr. 08/l-262 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që përmbajnë procedura të veçanta administrative dhe harmonizimin e tyre me ligjin nr. 05/l-031 për procedurën e përgjithshme administrative faza e dytë.
- Ligji për mbrojtjen nga Zhurma Nr. 02/L-102
- Ligji për mbrojtjen nga zjarri Nr. 08/L-261
- Ligji për ndërtim Nr. 04/L-110
- Ligji për planifikim hapësinor Nr. 03/L-106
- Udhëzimi administrativ për menaxhimin e vajrave të përdorura dhe mbeturinat me vajra (15/2012).
- Udhëzimi administrativ për vlerat kufizuese të efluentit që shkarkohet në trup ujorë dhe në rrjetin e kanalizimit publik (13 /2008).
- Udhëzimi administrativ nr. 29/2014 për menaxhimin e lumit nga trajtimi i ujërave të ndotura.
- Udhëzimi administrativ nr.03/15 për autorizim mjedisor.
- Ligji nr. 04/l-197 për kimikate.

Duke u nis nga fakti se një pjesë e madhe e mardhënjeve specifike nga lëmia e mjedisit nuk është përfshirë në rregullativat e tanishme prandaj për nevojat të këtij raporti është shfrytëzuar përvoja e mirë dhe rregullat relevante ndërkombëtare, direktivat përkatëse për mjedis si që është direktiva e VNM-s.



2.2. Metodologjia e punës

Menyra, forma dhe qasja në perpilimin e raportit të VNM-së është realizuar në praktkat më të mira profesionale përmes metodologjis se punës që ka kaluar në disa faza:

- a) Informatat themelore
- b) Vlerësimi i ndikimeve sipas kualifikimeve
- c) Analiza e rrezikut
- d) Përcaktimi i masave mbrojtëse

Këto hapa përfshinë:

a) Informatat themelore që nënkupton identifikimet:

- burimet themelore të ndikimeve në mjedis,
- popullata ekzistuese me karakteristikat demografike,
- karakteristikat e dheut, topografia dhe peisazhi në lokacionin e ndërtimit,
- klima e lokacionit me të dhënat meteorologjike,
- kualiteti i ajrit dhe ujit në lokacionin më të gjerë,
- bota bimore dhe shtazore në terrenin e analizuar.

b) Vlerësimi i ndikimeve sipas këtyre kualifikimeve:

- madhësia dhe lloji i ndotjes
- karakteristikat dhe dominimi i materialit ndotës
- gjendja e mjedisit në terrenin e analizuar
- vlerësimi i shpërndarjes në hapësirë i materies ndotëse

c) Analiza e rrezikut të:

- njeriut
- vlerave materiale
- vlerave natyrore

e) Përcaktimi i masave mbrojtëse:

në bazë të rezultateve të arritura mbi vlerësimin e ndikimit në mjedis në lokacionin ku zhvillohet aktivitei dhe ku është ndërtuar objekti per Impiantin per trajtimin e mbetjeve spitalore ne Spitalin e Prizrenit”.



2.3. Metodologjia e përgjithshme

Për të përmbushur rregullat e cekura më lartë, procesi i punës në këtë objekt Insenerator– Impiant per trajtimin e mbetjeve spitalore ne Spitalin e Prizrenit duhet të jetë në pajtim me të gjitha Ligjet dhe rregulloret e Republikës së Kosovës dhe atyre ndërkombëtare që parashihen në masat për mbrojtje të mjedisit.

Metodologjia e Përgjithshme për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Impiantin për Trajtimin e Mbetjeve Spitalore përfshin një qasje të strukturuar dhe të detajuar për të menaxhuar mbetjet spitalore në një mënyrë që respekton standardet e mbrojtjes së mjedisit dhe shëndetit publik. Mbetjet spitalore janë një kategori e veçantë mbetjesh që përfshijnë materiale të rrezikshme, bioteknologjike dhe kimike, që mund të kenë ndikime serioze në mjedis dhe shëndetin e njeriut nëse nuk trajtohen siç duhet. Kjo metodologji do të përfshijë hapa të detajuar, strategji të menaxhimit, dhe përdorimin e teknologjisë të përshtatshme për trajtimin dhe eliminimin e mbetjeve të lartëcekura spitalore.

Vlerësimi i Situatës dhe Analiza e Mbetjeve Spitalore

- **Identifikimi i llojit të mbetjeve:** Para se të fillojë trajtimi, duhet të bëhet një analizë e detajuar e llojit të mbetjeve spitalore. Ato mund të përfshijnë mbetje të zakonshme (duke përfshirë letra, plastika, etj.), mbetje biologjike (kërpudha, gjak, organe të hequra, etj.), mbetje kimike (medikamente të skaduara, disinfektantë), dhe mbetje të rrezikshme (p.sh. gjilpëra dhe mjete kirurgjikale të përdorura).
- **Klasifikimi i mbetjeve:** Mbledhja dhe klasifikimi i mbetjeve spitalore sipas rrezikshmërisë, përmbajtjes kimike dhe biologjike është thelbësore për të planifikuar trajtimin e duhur.

Përcaktimi i Objektivave të Mbrojtjes së Mjedisit

- **Reduktimi i ndotjes:** Sigurimi që trajtimi i mbetjeve të bëhet në përputhje me standardet e mbrojtjes së mjedisit, për të shmangur ndotjen e ajrit, ujit dhe tokës.
- **Parandalimi i rrezikut për shëndetin publik:** Mbetjet spitalore mund të përmbajnë patogjenë që rrezikojnë shëndetin e njerëzve dhe kafshëve, ndaj një metodologji e duhur e trajtimit është e nevojshme për të eliminuar këto rreziqe.
- **Respektimi i rregullave dhe ligjeve kombëtare dhe ndërkombëtare:** Duhet të sigurohet që të gjitha procedurat dhe teknologjitë që përdoren për trajtimin e mbetjeve spitalore të jenë në përputhje me kërkesat e ligjeve mjedisore dhe të shëndetit publik.

Menaxhimi i Mbetjeve në Pikën e Burimit

- **Mbledhja dhe ruajtja e sigurt:** Mbetjet spitalore duhet të mbledhen dhe ruhen në mënyrë të sigurt që të parandalohet ndotja dhe ekspozimi ndaj stafit dhe pacientëve. Kjo do të përfshijë përdorimin e kontejnerëve të mbyllur dhe etiketimeve të qarta për çdo lloj mbetjeje.
- **Pajisje dhe mjete të specializuara:** Duhet të përdoren mjete të specializuara për mbledhjen e mbetjeve të rrezikshme (p.sh. thika, gjilpëra, mbetje biologjike) për të reduktuar mundësinë e ndotjes ose ndodhisë së aksidenteve.



Transporti i Mbetjeve

- **Transporti i sigurt:** Transporti i mbetjeve spitalore nga spitali në impiantin e trajtimit duhet të jetë i sigurt dhe të respektojë rregullat e mjedisit dhe sigurisë. Mbetjet duhet të transportohen me mjete të veçanta, të sigurta dhe të mbyllura hermetikisht.
- **Higjena dhe kontrolli i transportit:** Mjetet e transportit duhet të pastrohen dhe dezinfektohen rregullisht për të parandaluar përhapjen e infeksioneve dhe kontaminimin.

Trajtimi i Mbetjeve Spitalore

Mbetjet spitalore mund të trajtohen në disa mënyra, dhe zgjedhja e metodës është e varur nga lloji i mbetjeve dhe risqet që ato përfaqësojnë. Disa nga metodat më të përdorura janë:

- **Incinatorët (Përdorimi i temperaturave të larta):** Incinere janë teknologji që përdoren për djegien e mbetjeve të rrezikshme dhe biologjike në temperatura shumë të larta. Ky proces eliminon patogjenët dhe mbetjet kimike, duke i kthyer ato në avuj dhe gazra të padëmshëm, të cilët mund të përpunohen për të reduktuar ndotjen e ajrit.
- **Autoklavimi:** Ky proces përdor avull të nxehtë për të sterilizuar mbetjet biologjike. Përdoret kryesisht për mbetjet që përmbajnë mikroorganizma patogjenë. Autoklavimi është një metodë më e butë krahasuar me incinerimin dhe mund të jetë një mundësi për mbetjet jo të rrezikshme.
- **Metoda kimike:** Përdorimi i kimikateve për dezinfektimin dhe neutralizimin e mbetjeve. Kjo metodë është e dobishme për trajtimin e mbetjeve që përmbajnë kimikate të dëmshme, përveç patogjenëve biologjikë.
- **Metoda e dehidrimit:** Ky proces mund të përdoret për mbetjet që përmbajnë shumë ujë, duke i transformuar ato në një masë të ngurtë dhe të thatë që mund të depozitohen më sigurt.

Menaxhimi i Djegies dhe Depozitimi i Sigurt i Mbetjeve të Trajtuar

- **Depozitimi i mbetjeve të trajtuara:** Pasi mbetjet janë trajtuar, ato mund të dërgohen në depozita të licencuara për hedhjen e mbetjeve të trajtuara, që duhet të jenë të përshtatshme për mbetje të rrezikshme dhe të mbyllura në mënyrë hermetike për të parandaluar ndotjen e mjedisit.
- **Monitorimi i ndotjes:** Pas depozitimit, është e nevojshme të kryhen kontrole periodike për të monitoruar mundësinë e ndotjes nga depozitat e mbetjeve dhe për të siguruar që nuk ka rrjedhje të substancave të dëmshme në mjedis.

Mbrojtja dhe Siguria e Punonjësve

- **Pajisje mbrojtëse:** Staf i që trajton mbetje spitalore duhet të jetë i pajisur me pajisje mbrojtëse personale (PPE), si doreza, maska, syze mbrojtëse dhe veshje speciale.
- **Trajnimi i stafit:** Të gjithë punonjësit që gjat aktiviteteve të tyre do të kenë kontakt me mbetjet duhet të kenë trajnimet adekuate varesisht prej pozicionit të punës. Punonjësit duhet të jenë të trajnuar për menaxhimin e mbetjeve, për të njohur procedurat e sigurisë dhe për të identifikuar llojet e mbetjeve që mund të jenë të rrezikshme. Në veqanti stafi që punon me pasijen për trajtimin e mbetjeve si në këto rast duhet të ketë trajnim të specializuar.



Monitorimi dhe Vlerësimi i Performancës

- **Kontrolli i cilësisë:** Procedurat e monitorimit të vazhdueshëm janë të domosdoshme për kontrollin e cilësisë. Duhet të kryhen inspektime dhe monitorime të rregullta për të siguruar që impianti për trajtimin e mbetjeve spitalore po funksionon siç duhet dhe që po respektohen standardet e mbrojtjes së mjedisit.
- **Vlerësimi i ndikimit mjedisor:** Ndërmarrjet e menaxhimit të mbetjeve e në këtë rast institucioni – Spitali i Prizrenit duhet të kryejnë vlerësime të ndikimit mjedisor të impiantit për trajtimin e mbetjeve dhe të marrin masa për të minimizuar ndotjen.

Raportimi dhe Dokumentimi

- **Raportimi i të dhënave:** Kjo përfshin dokumentimin e çdo etape të menaxhimit të mbetjeve, nga mbledhja dhe transporti deri te trajtimi dhe depozitimi. Të gjitha këto aktivitete duhet të jenë të dokumentuara dhe të mbështetura nga raporte.

Në Inseneratorin - impiantin që trajtohet në këtë raport përfshihen:

- **Klasifikimi i mbeturinave sipas katalogut Evropian KME-së**
- **18 01, 18 01 01, 18 01 03*, 18 02 01, 18 02 02***



3. PËRSHKRIMI I LOKACIONIT DHE MJEDISIT

Karakteristikat themelore të gjendjes ekzistuese të lokacionit janë bazë themelore për hartimin e Raportit të VNM. Hulumtimi dhe vlerësimi i gjendjes ekzistuese është bërë duke i shfrytëzuar të dhënat e ofruara nga investitori dhe vrojtimet e matjet e realizuara në terren. Për definimin e gjendjes ekzistuese në mënyrë të kënaqshme dhe për të u krijuar një bazë reale për hulumtim të ndikimeve të mundshme, në kuadër të gjendjes ekzistuese janë prezentuar edhe të dhënat relevante që kanë të bëjnë me të dhënat ekzistuese morfologjike, agrogjeologjike, hidrologjike, hidrografike dhe meteorologjike.

3.1. Potencialet ekzistuese

Njëri nga elementet kyç të hulumtimi i gjendjes ekzistuese të mjedisit është hulumtimi i potencialit ekzistues, e që konsiston në analizën e mirëfilltë të tërësisë hapësinore në zonën më të gjerë të ndërtimit, me qëllim që në bazë të pasojave të njohura të vlerësohen mundësitë e rrezikut ekologjik dhe në bazë të tyre të rekomandohen masat për zvogëlimin ose edhe eliminimin e tyre. Karakteristikat e potencialit ekologjik përbëhen nga kombinimi i ndikimeve të ndërsjellëta të faktorëve natyror si: *toka, uji, ajri, relievi, flora dhe fauna*.

3.2. Pozita gjeografike e komunes së Prizrenit

Komuna e Prizrenit është njësi administrative në pjesën jugorë perëndimorë të Kosovës në pozitën gjeografike 42° 13' 0" Veri 20° 44' 0" Lindje. Komuna e Prizrenit është njësi administrative në pjesën jugore të Kosovës, me një sipërfaqe prej 640 km² (5.94% të territorit të Kosovës) gjendet në jugperëndim të Kosovës dhe me 76 vendbanime dhe me 178.112 banorë nga të cilët në Prizren janë rreth 120.000 banorë.

Sipërfaqja e kësaj komune është 361 km² që mbulon 3.3 % të territorit të Kosovës. Nga sipërfaqja e komunës, që përfshin 36.099ha (ose 361 km²), prej tyre 15.074 ha ose 41.7 % janë të mbuluara me pyje, 19.373 ha ose 53.7 % janë tokë bujqësore dhe 1.652 ha ose 4.6% sipërfaqe tjetër.

Nëpër territorin e kësaj komune, me një pozitë të mirë gjeografike, kalojnë rrugë shumë të rëndësishme që e lidhin kryeqendrën, Prishtinë, me qendrën regjionale Ferizaj, Peje, Gjakove dhe kalojnë më tej në Shqipëri. Si e tillë ajo ka një pozitë të rëndësishme strategjike në këtë pjesë të Kosovës.

3.3. Pozita gjeografike e lokacionit

Lokacioni i objekti ekzistues të Impiantit për trajtimin e mbetjeve spitalore gjendet në hapësirat e kompleksit të Spitalit të Përgjithshëm në Komunen e Prizrenit, ngastra kadastrale (objekti) nr.08442-0-315-0 . Objekti do të ketë dalje në rrugën kryesore "Xhevat Berisha".



Figure 1. Lokacioni i objektit.



Figure 2. Foto nga terreni.

3.4. Popullsia

Një nga veçoritë qenësore të hapësirës së analizuar, në kontekstin e përcaktimit të ndikimeve të mundshme në mjedis, është popullata dhe demografia e saj. Për të kuptuar plotësisht këto fakte, është e nevojshme një hulumtim i detajuar mbi ndikimet e mundshme negative në banorët që jetojnë në këtë hapësirë. Lokacioni ku ndodhet objekti, konkretisht Inseneratori – Impianti për trajtimin dhe sterilizimin e mbeturinave mjekësore, gjendet në fund të kompleksit spitalor. Në këtë zonë, kryesisht ndodhen vetëm objektet e Spitalit të Përgjithshëm në Prizren, ndersa ne periferi janë objektet e vendbanimeve dhe industriale.



Figure 3. Lokacioni i objektit.

3.4. Infrastruktura ekzistuese

Për qasje në lokacionin ku është objekti ekzistues të Inseneratorin – Impiantin për trajtimin e mbetjeve spitalore në Spitalin e Prizrenit”, qasja është përmes rrugës kryesore “Xhevat Berisha” e cila e lidhë lokacionin me të gjithë rrjetin rrugor të Prizrenit. Edhe infrastruktura e ujesjellesit, kanalizimit dhe rrjetit elektrik është e rregulluar.

3.5. Ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore

Prizreni ndodhet në pjesën jugore të Kosovës, në Rrafshin e Dukagjinit dhe rrëzë Maleve të Sharrit, rreth 80 km nga kryeqyteti Prishtina dhe furnizohet me ujë nga Burimet pranë lumit Lumbardhi, degë e majtë e lumit Drini i Bardhë. Lumbardhi është afluenti më i madh i Drinit të Bardhë me një rrjedhë mesatare në Prizren prej 4.6 m³/s. Drini i Bardhë drenazon pjesën perëndimore të Kosovës drejt Shqipërisë dhe në Detin Adriatik. Rrjedha mesatare në kufirin me Shqipërinë është 56 m³/s. Te kufiri i Shqipërisë është nën ndikimin e oscilimeve të nivelit të ujit të liqenit artificial “Fierza”.

Në tabelën në vijim janë paraqitur disa të dhëna për disa akumulues nëntokësorë për Pellgun e Drinit të Bardhë.

Nr.	Akumulimi nëntokësor	Pellgu (km ²)	Vëllimi i dobishëm (m ³)	Kapaciteti vlerësues	
				m ³ /sec	Gjithsej m ³)
1	Istog	76	12 x 10 ⁶	2.8	89 x 10 ⁶
2	Vrellë	28	14 x 10 ⁶	0.600	19 x 10 ⁶
3	Drini i Bardhë	90	14 x 10 ⁶	3.23	102 x 10 ⁶
4	Lubizhdë	42	14 x 10 ⁶	42(150)	55 x 10 ⁶
5	Pejë	300	37.5 x 10 ⁶	4.0(150)	52 x 10 ⁶
6	Deçan	144	33 x 10 ⁶	3.5(150)	45 x 10 ⁶
7	Lloqan	39	12 x 10 ⁶	1.2(150)	15 x 10 ⁶
8	Krk Bunar	81	10 x 10 ⁶	)	50 x 10 ⁶
9	Korishë	18	3.6 x 10 ⁶	1.6	12 x 10 ⁶
10	Fusha e Therandës	50	77 x 10 ⁶	0.38	63 x 10 ⁶
				2	
Gjithsej		998	271 x 10 ⁶	271 x 10 ⁶	511 x 10 ⁶



Fig.2. Tabela e ujerave nëntoksore

3.6. Flora dhe Fauna

Në lokacionin ku ndodhet objekti i Impiantit për trajtimin e mbetjeve spitalore në Spitalin e Prizrenit, vegjetacioni i këtij lokaliteti është i dominuar nga drunjtët që janë të kultivuar dhe llojet bimore në pjeset e tereneve të gjelbruara. (Sambucus nigra) dhe kulumrija (Prunus spicosa). Prej llojeve bimore të kultivuara janë: Pisha e zezë (Pinus nigra), hormoqi (Picea abies), një dru cedri (Cedrus sp.), arra (Juglans regia), molla (Malus sp.), kumbulla (Prunus), etj. Afër parkingjeve dhe në vende me drunjtë janë prezente edhe Ajuga laxmani, Lathyrus niger, Inula salicina, Potentilla micrantha, Viola odorata, V. sylvestris, Typha latifolia, Mentha longifolia etj. Duke u bazuar në observimet direkte në këtë lokacion dhe nga bisedat me banoret lokal nga grupi i gjitarëve nuk kanë hasur në ndonjë specije në lokacionin në fjalë. Nga grupi i zogjve janë vërejtur; harabeli (Passer domesticus), trishtili (Parus sp.), qafka, gala (Corvus coronea dhe Corvus cornix), pëllumbi urban (Columbia livia) etj. Janë vërejtur edhe qerdhe të zbrazta të dallëndyshes (Hirundo rustica) si dhe lloje të ndryshme të shpëndeve.

3.7. Kushtet klimatike

Territori ku ndodhet objekti i Impiantit për trajtimin e mbetjeve spitalore, kryesisht ka klimë kontinentale dhe mediterane të modifikuar që karakterizohet me vera të nxehta dhe dimra të ftohtë e të pasur me reshje sidomos gjatë vjeshtës, dimrit dhe pranverës së hershme. Reshjet janë të pranishme sidomos gjatë vjeshtës, dimrit dhe pranverës, dhe ato janë të formës së ndryshme (shi, borë, breshër) me karakter të gjerë gjatë dimrit ose me karakter lokal gjatë pranverës dhe verës. Gjatë periudhës vegjetative në Prizren, sasia e reshjeve zakonisht luhet nga 400 deri në 700 mm, varësisht nga vitet dhe kushtet klimatike. Reshjet më të shpeshta zakonisht ndodhin në muajt e Pranverës: në muajin Mars (20-60 mm); Prill (40-100mm); Maj (40-80mm) dhe Vjeshtës: Shtator (40-80mm); Tetor (50-70mm) dhe në Nëntor (50-100 mm), ndërsa më së paku ka në muajt e verës: Qershor (30-40 mm); Korrik (20-30mm); Gusht (20-30mm).

Temperatura mesatare për të gjithë vitin në komunën e Prizrenit është rreth 10°C deri në 13°C. Temperaturat më të larta janë regjistruar në muajin korrik dhe gusht, temperaturat mund të arrijnë deri në 35°C ose më shumë, ndonjëherë edhe më të larta në ditët më të nxehta, temperaturat minimale mund të bien deri në -10°C.

Erat në komunën e Prizrenit zakonisht vijnë nga perëndimi dhe veriperëndimi. Këto erëra janë të zakonshme gjatë verës dhe ndihmojnë në sjelljen e ajrit të freskët. Gjithashtu, në dimër, erërat mund të vijnë nga lindja ose veriu, duke sjellë ajër më të ftohtë.

3.8. Ajri

Në territorin e Komunës së Prizrenit koeficienti ndotjes së ajrit ka arritur mesataren gjatë sezonit të dimrit veçanërisht nga mesi i nëntorit deri në shkurt për shkak të përdorimit të lartë të ngrohjes, që shpesh përfshin lëndë djegëse fosile dhe materiale të tjera ndotëse. Koeficienti i ndotjes së ajrit, siç matet me PM (partikulat e imta), mund të arrijë deri në 150-200 PM. Këto matje janë të realizuara nga tre (3) stacione të cilat janë vendosur në lagje të ndryshme për të ofruar një pamje të plotë të cilësisë së ajrit në qytet. Llogaritjet e vlerave janë si rezultat i matjeve ditore të cilat kryhen dhe interpretohen në



mënyre digjitale nga senzorët. Interpretimi i të dhënave bëhet tri herë në ditë në sistemin online, ku si rrjedhojë nxjerrët mesatarja ditore e cila përfshinë matjet e mëngjesit, mesditës dhe mbrëmjes.

Kemi vërejtur se frekuenca e lartë e automjeteve në rrugët e qytetit të Prizrenit ka një ndikim të rëndësishëm në ndotjen e ajrit. Kjo përfshin gazrat, pluhurin dhe ndotjet e tjera automobilistike, veçanërisht nga makinat e vjetra, të cilat shpesh lëshojnë vajra në asfalt. Gjatë reshjeve, këto vajra depërtojnë në shtresat e poshtme të asfaltit, duke kontribuar në ndotjen e ajrit. Me gjithatë, mund të konkludohet se pastërtia e ajrit në këtë rajon nuk është në nivelin e dëshiruar. Prizreni, si qytet në zhvillim, përballlet me sfida të shumta përsa i përket ndotjes. Mungesa e hapësirave të gjelbra të mjaftueshme dhe afërsia me burime natyrore që mund të ndihmojnë në pastrimin e ajrit e përkeqëson situatën.



4. PËRSHKRIMI I PAISJES DHE PROCESIT

4.1. Pershkrimi i objektit

Objekti ku ndodhet inseneratori – impianti për trajtimin e mbetjeve spitalore, është i vendosur brenda parcelës së Spitalit të Përgjithshëm të Prizrenit. Me dimensione 11.51 m x 6.67 m dhe një $S_{BRUTO} = 77.80 \text{ m}^2$. (Objekti është ndërtuar nga MMPHI). Struktura arkitektonike e objektit ka etazhitet P+0. Më poshtë gjenden karakteristikat teknike dhe projekti i objektit:

Nr.	Destinimi	Sip. (m^2)	Për (m')	H (m')
1	Zyre e personelit	5.82	9.72	3.40
2	Hapesira ku është vendosur Inseneratorin – Impiantin për trajtimin e mbetjeve spitalore	43.18	30.66	3.40
3	Garderoba e stafit	3.4	7.54	3.40
4	Banjo / WC	4.25	8.94	3.40
5	Depo e mbeturina	6.5	10.4	3.40




Figure 4. Skema e procesit teknologjik.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministry of Environment and Spatial Planning

No. i Brevetës
No. of License: 000503

**LICENCE -- LICENCA -- LICENCE
PER ADMINISTRIMIN E MBETURINAVE
ZA UPRAVLJANJE OTPADA
FOR WASTE ADMINISTRATION**

Kemi i personit:
Last Name: Spitali Rajonal "Prim. Dr. Daut Mustafa" nr. regji brendit: 90001345
Name of person: Re. "Sheh Eni" p.a. Prizren
Adresa:
Address: Afrim Arifi nr. person: 1003705508
Adresat:
Manager of law: Sahar Busheti nr. person: 1004796643
Drejtori ligjor:
Manager of law:
Drejtori teknik:
Technical manager:

Vapërdoruesi për M&M-Deletant UO-Activity of WM

Trajtim fizik sterilizim me avull në automata të mbeturinave infektive dhe potencialisht infektive me
Nr. të KEM 180101; 180102; 180103; 180104; 180201; 180202.

Licenca vlen deri më: - Licenca valid do: - Validity of license: 05.03.2020

The book is valid 25 to 26 days per
substitution no. 04/1-000 dhe
Laborator Administrativ no. 9/2014,
Javërit i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Dati:
Date: 04.03.2020
Prizren

V.V.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Spitali Rajonal
"Prim. Dr. Daut Mustafa"
Prizren



Regional Hospital
"Prim. Dr. Daut Mustafa"
Prizren

Impianti per sterilizimin e mbetjeve spitalore
Raporti Vjetor: Janar-Dhjetor 2020

Nr.	Repartet	Thas	Kutia	KG	%	Verejtje
1	Dializa	20086	201	75204	78.15%	
2	Interno	322	126	2111	2.19%	
3	Nj koronare	90	16	499	0.52%	
4	Neurologjia	211	49	1210	1.26%	
5	Krahori	215	50	1273	1.32%	
6	R infektiv	281	44	1612	1.68%	
7	Psikiatria	48	18	272	0.28%	
8	Ginekologjia	89	24	502	0.52%	
9	Akusheria	60	33	398	0.41%	
10	Materniteti	65	26	435	0.45%	
11	Neonatalogjia	77	31	468	0.49%	
12	S.op.ginekologji	187	37	1112	1.16%	
13	Pediatrica	211	40	1188	1.23%	
14	Anestezioni	32	13	107.7	0.20%	
15	Ohoma e zgjimit	10	22	109.3	0.11%	
16	Kujdesi intensiv	46	18	263	0.27%	
17	Emergjenca	148	78	953	0.99%	
18	Kirurgjia	165	39	900	0.94%	
19	Urologjia	65	20	351	0.36%	
20	Ortopedia	96	108	738.6	0.77%	
21	Ori	73	60	584	0.61%	
22	Oftalmia	24	42	241.8	0.25%	
23	S.op.kirurgjike	26	20	177	0.18%	
24	S.op.ori-oftalmia	33	12	169	0.18%	
25	Laboratori	12	600	1757	1.83%	
26	Transfuzioni	1	207	497	0.52%	
27	Ro kabinetit	0	81	381.1	0.39%	
28	Transfuzioni	0	139	388	0.40%	Gjak i shkuar
29	Barnatorja	81	326	1192.7	1.24%	
30	Lab.NEA-LAB	3	183	742.6	0.77%	
31	OKMF	44	23	256.7	0.27%	
32		2	28	78	0.08%	
33		0	23	61	0.06%	
Totali		22783	2740	96227.5	100.00%	

Totali i okleve: 1439
Totali i Kg: 96227.5
Prizren
31.12.2020

Shefi i shërbimit
Vendosja

Inseneratori për trajtimin e mbetjeve spitalore në Spitalin Rajonal "Daut Mustafa" në Prizren përdoret që nga viti 2011. Ky insenerator ka qenë i licencuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, me licencën e vlefshme deri më 05.03.2020. Në vitin 2022, u vendos paisja e re ECODAS T300, e cila përmirëson procesin e trajtimit dhe sterilizimit të mbetjeve spitalore. Te bashkangjitur gjeni licencën e paisjes së vjetër, si dhe raportet vjetore të sterilizimit të mbetjeve spitalore. Këto dokumente janë të rëndësishme për të ndjekur përputhshmërinë me standardet mjedisore dhe për të siguruar transparencë në menaxhimin e mbetjeve.



Spitali Rajonal
"Prin. Dr. Daut Mustafa"
Prizren



Regional Hospital
"Prin. Dr. Daut Mustafa"
Prizren

Spitali Rajonal
"Prin. Dr. Daut Mustafa"
Prizren



Regional Hospital
"Prin. Dr. Daut Mustafa"
Prizren

Implanti për Asgjësimin - Sterilizimin e mbejtjeve Spitalore
Raporti Vjetor: Janar-Dhjetor 2021

Nr.	Repartet	Thasë	Kutia	KG	%	Verejtje
1	Hemodializa			78180	79.34%	
2	Interno			1949	2.03%	
3	Infektiva			1638	1.71%	
4	Pulmologjia			1645	1.71%	
5	Neurologjia			1034	1.06%	
6	Psikiatria			368	0.38%	
7	Gjinekologjia			351	0.37%	
8	Akusheria			283	0.29%	
9	Materniteti			108	0.11%	
10	Neonatalogjia			286	0.30%	
11	Pediatrica			1154	1.20%	
12	S op gjinekologji			187	0.19%	
13	Kirurgjia			1198	1.25%	
14	Urologjia			623	0.65%	
15	Ortopedia			499	0.52%	
16	Orl			552	0.57%	
17	Oftalmologjia			74	0.08%	
18	S op Kirurgjike			49	0.05%	
19	S op Orl-Ofitalmo			51	0.05%	
20	M.I.Q.			387	0.40%	
21	Emergjencia			1121	1.17%	
22	Laboratori			1996	2.06%	
23	Transfuzioni			679	0.71%	
24	Transgji skaduar			427	0.44%	
25	Ro Kabineit			73	0.08%	
26	Qkmf-Prizren			1763	1.84%	
27	Qkmf-Suhareke			847.3	0.88%	
28	Qkmf-Mamushe			141	0.15%	
29	Ishp-Prizren			126	0.13%	
30	Edi-Lab			59	0.06%	
31	Akat			122	0.13%	
32	Kuki-Dent			29	0.03%	
33	Dia-Lab			23	0.02%	
Totali				96.022	100.00%	

Totali i cikleve 1103
Totali i Kg 96.022
Prizren
31.12.2021

Shf. i Shërbimit
Vedat Selmani

Implanti për Asgjësimin - Sterilizimin e mbejtjeve Spitalore
Raporti Vjetor: Janar-Dhjetor 2022

Nr.	Repartet	Thasë	Kutia	KG	%	Verejtje
1	Hemodializa	0	0	77667	72.73%	
2	Interno	0	0	2097	1.06%	
3	Infektiva	0	0	1335	1.25%	
4	Pulmologjia	0	0	1902	1.78%	
5	Neurologjia	0	0	1488	1.39%	
6	Psikiatria	0	0	544	0.51%	
7	Gjinekologjia	0	0	602	0.56%	
8	Akusheria	0	0	1117	1.05%	
9	Materniteti	0	0	1290	1.21%	
10	Neonatalogjia	0	0	830	0.78%	
11	Pediatrica	0	0	1084	1.02%	
12	S op Gjinekologji	0	0	1845	1.73%	
13	Kirurgjia	0	0	1342	1.26%	
14	Urologjia	0	0	820	0.82%	
15	Ortopedia	0	0	1145	1.07%	
16	Orl	0	0	640	0.60%	
17	Oftalmologjia	0	0	405	0.38%	
18	S op Kirurgjike	0	0	345	0.32%	
19	S op Orl-Ofitalmo	0	0	615	0.58%	
20	M.I.Q.	0	0	911	0.85%	
21	Emergjencia	0	0	861	0.81%	
22	Laboratori	0	0	1876	1.76%	
23	Transfuzioni	0	0	644	0.60%	
24	Transgji skaduar	0	0	478	0.45%	
25	Ro Kabineit	0	0	942	0.88%	
26	Dermatologjia	0	0	33	0.03%	
27	QKMF-Prizren	0	0	2792	2.61%	
28	QKMF-Suhareke	0	0	200	0.19%	
29	Qkmf-Malushe	0	0	621.7	0.58%	
30	QKMF-Mamushe	0	0	0	0.00%	
31	Akat Shpk	0	0	132	0.12%	
32	Edi-Lab	0	0	82	0.08%	
33	Kuki-Dent	0	0	23	0.02%	
Totali				106782.7	100.00%	

Totali i cikleve 1057
Totali i Kg 106782.7
Prizren
31.12.2022

Shf. i Shërbimit
Vedat Selmani

Spitali i Përgjithshëm
"Prin. Dr. Daut Mustafa"
Prizren



Implanti për sterilizimin e mbejtjeve spitalore

Nr.	Repartet	Thasë	Kutia	Kilogram	%
1	HEMODIALIZË	12528	148	48019	84.49%
2	INTERNE	287	90	1822	2.45%
3	INFJEKTIVE	207	30	1054	1.43%
4	PULMOLOGJI	226	47	1325	1.78%
5	NEUROLOGJI	201	26	1137	1.53%
6	PSIKIATRI	178	33	991	1.29%
7	AKUSHERIE	89	17	480	0.65%
8	GJINEKOLOGJI	145	26	722	0.97%
9	AKUSHERIA	196	55	1172	1.58%
10	SAL LATE LINDIES	161	27	814	1.09%
11	NEONATOLOGJI	182	25	918	1.24%
12	PEDIATRI	157	26	916	1.23%
13	S OP GJINEKOLO	177	33	1023	1.38%
14	KIRURGI	260	40	1345	1.81%
15	UROLOGJI	216	31	1133	1.55%
16	ORTOPEDI	234	36	1258	1.69%
17	ORL	167	28	855	1.15%
18	OFTALMOLOGJI	114	17	550	0.74%
19	S OP KIRURGJIK	123	28	752	1.01%
20	S OP ORL	96	17	482	0.65%
21	S OP OFTALMOLOG	83	14	409	0.55%
22	TRANSFUZIONI	0	353	883	1.19%
23	TRANSFUZIONI	0	141	518	0.70%
24	RO KABINETI	0	145	269	0.36%
25	EMERGENCY	183	39	1001	1.35%
26	LABORATORI	0	618	1627	2.19%
27	MIO	214	37	1046	1.41%
28	FATIM-M	0	11	28	0.04%
29	MEDICAL CENTER	0	247	840	1.13%
30	VITALAB	0	54	230.7	0.30%
31	EALTHROMATE	0	47	216.2	0.29%
32	AS DENTAL	0	18	45.7	0.06%
33	DENTAL	0	8	17.8	0.02%
34	INI FARM	0	47	71.7	0.10%
35	NASUT GERDIELLA	0	7	12.6	0.02%
36	EMA DENT	0	6	85.3	0.11%
37	B DENT	0	7	14.3	0.02%
38	KUKI DENT	0	4	7.5	0.01%
39	METI DENT	0	2	2.4	0.00%
40	HEMO LAB	0	1	1	0.00%

Totali Kg 74262
Totali i cikleve 663

15.01.2024 Prizren

Shf. i Shërbimit
Vedat Selmani



4.2. Pershkrimi i paisjes

Inseneratori për trajtimin e mbetjeve spitalore është i tipit ECODAS T300, e prodhuar nga kompania Ecodas në Francë. Pajisja është testuar nga Institut Pasteur de Lille dhe është miratuar nga Superior Council of Public Hygiene of France (CSHPF), në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Mjedisit. Bashkangjitur gjeni dokumentin përkatës:

The American Society of Mechanical Engineers



CERTIFICATE OF AUTHORIZATION

The named company is authorized by The American Society of Mechanical Engineers (ASME) for the scope of activity shown below in accordance with the applicable rules of the ASME Boiler and Pressure Vessel Code. The use of the ASME Single Certification Mark and the authority granted by this Certificate of Authorization are subject to the provisions of the agreement set forth in the application. Any construction stamped with the ASME Single Certification Mark shall have been built strictly in accordance with the provisions of the ASME Boiler and Pressure Vessel Code.

COMPANY:

Ecodas
28 Rue Sebastopol
Roubaix 59100
France

SCOPE:

Manufacture of pressure vessels at the above location only

AUTHORIZED: December 17, 2023

EXPIRES: December 17, 2026

CERTIFICATE NUMBER: 59077

Board Chair, Conformity Assessment

Managing Director, Standards & Engineering Services





Karakteristikat e Përgjithshme:

Dimensionet (L x W x H)	270 x 210 x 330 cm
Pesha e transportit	2000 kg
Pesha maksimale kur mbushet me ujë	3100kg
Rezistenca ne shtypje	2 kg/ cm ²
Presioni i avullit	8 bar
Rrjedha maksimale e avullit	170 kg/h
Ajri i kompresuar	6 bar
Energjia elektrike 380 V / 3-Fazor	14 kW

Konsumimi per cikël:

Avulli	15 kg
Elektrike	1.7 Kwh
Uje	25 l

Karakteristikat e Operimit:

Temperatura e trajtimit	130-177 °C
Koha mesatare e ciklit	30 Min
Kapaciteti maksimal i vëllimit të ngarkimit	507 L
Kapaciteti mesatar i vëllimit të procesit	350 L
Dendësia mesatare e mbetjeve	100-150 kg/m ³
Kapaciteti mesatar i peshës së procesit	35-53 kg/ cikli
Inaktivizimi mikrobial	10 ⁸
Reduktimi i vëllimit të mbetjevec	80 %
Reduktimi maksimal i peshës së mbeturinave (në varësi të natyrës së mbeturinave)	40 %

Studim rasti

Dimensionet e setit	40 m ²
Koha mesatare e ciklit Ngarkesa deri në ngarkim	30 min
Kapaciteti i vëllimit	350 l
Kapaciteti mesatar i peshës së procesit	35-53 kg/cikel

NUMRI I NDËRRIMEVE	KAPACITETI MESATAR VJETOR I MAKINAVE
1 Nderrim – 40 orë/javë	183 T
2 Nderrim – 80 orë/javë	366 T
3 Nderrim – 120 orë/javë	550 T



Në bashkëngjitje, ju ofrojmë fotot e marra nga terreni, si dhe skicat e detajuara të saj.




Figure 5. Fotot e marra nga terreni, si dhe skicat e detajuara të pajisjes.

4.3. Procesi i Riciklimit

Inseneratori për trajtimin e mbetjeve spitalore (ECODAS T300) copëton të gjithë materialin, kapaku i enës mbyllet përpara fillimit të ciklit të trajtimit me avull për të siguruar efikasiteti i sterilizimit me avull gjatë gjithë ngarkesës. Sistemi përdor avull të injektuar direkt dhe presion për të sterilizuar të gjitha mbetjet infektive, duke tejkaluar autoklavimin tradicional duke i bërë mbetjet të panjohshme për shkak të sistemit të integruar të grirësës. Temperatura, presioni dhe koha monitorohen dhe mirëmbahen vazhdimisht përmes sistemit të integruar të kontrollit. Arrin inaktivizimin mikrobial më të madh se 10^6 . CODAS është projektuar për të trajtuar një gamë të gjerë mbetjesh mjekësore, duke përfshirë mbetjet spitalore dhe laboratorike, mbetjet mjekësore të lëngshme dhe të ngurta, mostrat e gjakut, mbetjet e mprehta dhe patologjike, kulturat dhe rezervat, si dhe çdo mbetje tjetër të përcaktuar në rregulloret lokale, shtetërore dhe federale. Për shkak të fleksibilitetit të tij, ECODAS mund të ofrojë



zgjidhje për ofruesit e kujdesit shëndetësor, si spitalet private dhe publike, laboratorët dhe qendrat e trajtimit. Procesi mesatar i trajtimit zgjat 30 minuta dhe është plotësisht i automatizuar, me një sistem kontrolli kompjuterik që monitoron procesin dhe printon automatikisht një raport grupi në fund të çdo cikli, për të siguruar mbajtjen e saktë të të dhënave.

- Mbeturinat mjekësore që mund të hidhen në insenerator përfshijnë:

- Shiringat
- Sistemet e infuzioneve
- Sistemet e transfuzionit, komplet me qeset e gjakut
- Ambalazhet e infuzioneve dhe monitorin
- Materialin e hemodializës (veshkorja, sistemet, kompresate të vogla etj.)
- Qeset urinare të zbrazura
- Kutitë e shiringave kompletuar
- Epruvat laboratorike

Procesi i trajtimit dhe sterilizimit të mbetjeve medicinale në sistemin ECODAS T300 përbëhet nga disa faza të rëndësishme:



SHEMBULLI I CIKLIT TE TRAJTIMIT ECODAS T300




Figure 6. Në foto shembulli i ciklit te trajtimit.

1. NDARJA E MBETURINAVE MEDICINALE - Ndarja e mbetjeve spitalore bëhet në dy grupe kryesore, të cilat futen në qese të ndryshme:

1. **Qeset e zeza:** Vendosen materiali i hemoializes (veshkorja, sistmet, kompresate vogla etj.)
2. **Qeset e verdha:** Këtu futen mbeturinat infektive dhe ato të rrezikshme, përfshirë materiale si: Shiringat; Sistemet e infuzioneve komplet me qeset e gjakut; Ambalazhet e infuzioneve dhe monitolin; Qeset urinare te zbrazta; kutit e shiringave complete; Epruvetat e laboratorit. Bashkangjitur gjeni mbeturinat te cilat mund te hidhen ne insenatori dhe mbeturinat te cilat rreptesisht ndalohen:



SPITALI RAJONAL REKONSTRUKCIONAL "R. HASTANOSI" "Prin Dr. Don Rastali" si Prizren Rruga "Sheh Enver" p.z. - 29 000 Prizren-Kosovë Të. : + 351 (0) 29/222 222 dhe faks: +381 (0) 29/243 134	
Memorandum	
Data/Date/Datum:	23.08.2014 Nr. 274/27
Për/To/ Za:	Stafin udhëheqës të Spitalit
Përmas /Through /Preko:	Arhivi
Nga/From/Od:	Qazim Gashi drejtor i administratës
Linda/ Subject/ Tema:	NJOFTIM
Co/Ce:	

NJOFTIM

Me anë të kësaj shkrese **NJOFTOHEN** të gjithë punëtorët e Spitalit rajonal se **RREPTËSISHT NDALOHEJ** hedhja nëpër esë të cilat janë të dedikuara për asgjësim për **INSEKTOR** të këtyre gjësëndeve:

1. PLACENTAVE;
2. MEDIKAMENTEVE TË NDRYSHME (ampulla, tableta, suposte, etj.);
3. MBETJET ORGANIKE NGA SALLAT E OPERACIONIT (kirurgji, Gjinekologji, Urologji, etj.);
4. RROBAVE TË NDRYSHME (mantelave, çarçafave etj.);
5. MBETURINAVE TË FORTA (hekur, etj.).


Me respekt !

MBETURINAT MEDICINALE TË CILAT MUND **TE HUDHEN NË INSEKTOR**

1. SHIRINGAT,
2. SISTEMET E INFUZONEVE,
3. SISTEMET E TRANSFUZIONIT KOMPLET ME QESEN E GJAKUT,
4. AMBALAZHET E INFUZONEVE DHE MONITOLIN,
5. MATERJALI I HEMODIALIZËS (veshkorja, sistmet ,kompresate vogla etj.),
6. QESET URINARE TË ZBRAZTA,
7. KUTIT E SHIRINGAVE KOMPLETË,
8. EPRUVETAT E LABORATORIT.


Dokumente zyrtare të leshuara nga udhëheqësit e inseneratorit për repartet e spitalit në Prizren

2. NGARKIMI – mbetjeve spitalore bëhet përmes hapjes së sipërme, ku mbeturinat e klasifikuara dhe të paketuara ngarkohen në pajisje të përshtatshme që kanë kapacitet mesatar peshe prej 35-53 kg për cikël.






- 3. COPETIMI (THERMIMI)** - fillon pasi kapaku të jetë mbyllur, vulosur dhe kyçur. Karakteristikat e copetimit përmban rrotullim automatik të kundërt për të parandaluar bllokimin.




- 4. NGROHJA** – behet duke përdorur avull, ne temperature 138°C (280 F) dhe presionin 3.5 bar (51 psi).






5. **STERILIZIMI** – arrihet duke ruajtur presionin dhe nxehtësinë për 10 minuta (koha/temperatura e rregullueshme për dendësinë e materialit). Ky proces arrin inaktivizimin mikrobial të reduktimit prej $10^6 - 10^8$.




6. **FTOHJA** – Pas serilizimit, paisja mbushet me uje permes rezervuarit duke ulur temperaturën në 80°C (176 F) dhe presionin ne 0 bar (0 psi) për t'u përgatitur për hapjen e sistemit.



7. **KULLIMI** - kondensatës dhe ujit derdhen në kanalin sanitar.



8. **SHKARKIMI** – mbetjet e sterilizuara hidhen ne shporten perkatese me pas transportohen deri ne deponimin me mbeturinat tjera, ndërsa lëngu shkarkohet ne rrjetin e kanalizimit te objektit.



Ky proces siguron një trajtim të sigurt dhe efikas të mbetjeve spitalore, duke reduktuar rrezikun e infeksioneve dhe duke kontribuar në mbrojtjen e mjedisit.




Figure 7. Paraqitja grafike e ciklit te sterilizimit.




Figure 8. Paraqitja skematike e procesit teknologjik.



NE PËRPUTHJE ME LIGJI NR. 02/L-30, SHTOJCA 01, KATALLOGU I MBETURINAVE KEMI:

Klasifikimi i mbeturinave sipas katalogut Evropian të mbeturinave, në bazë të origjinës së mbeturinës ndahen në 20 – grupe, paraqitur në tabelën I, mbetjet spitalore bëjnë pjesë në grupin 18si me poshte:

- 18 MBETURINAT NGA SHËRBIMET SHËNDETËSORE TË NJERËZVE DHE/ APO ZBULIMET E TILLA (përveç mbeturinave nga kuzhinat dhe restorantet që nuk janë burim i drejtpërdrejt i shërbimeve shëndetësore)
- 18 01 Mbeturinat nga lindjet, diagnostifikimet, trajtimet apo parandalimet e sëmundjeve të njerëzit
- 18 01 01 Mjetet e mprehta (përveç 18 01 03)
- 18 01 02 Pjesë të trupit organet përfshirë qeset e gjakut dhe gjaku i rezervuar (përveç 18 01 03)
- 18 01 03* Mbeturina, mbledhja apo hudhja e të cilave kërkon përkujdesje të posaçme në mënyrë që të parandalohet infektimi
- 18 01 04 Mbeturina, mbledhja apo hudhja e të cilave nuk kërkon përkujdesje të posaçme në mënyrë që të parandalohet infektimi (p.sh. fashat, mbështjellës nga gipsi, çarçafët, veshjet për një përdorim, pelenat)
- 18 01 06* Kemikalet që janë apo përmbajnë substanca të rrezikshme
- 18 01 07 Kemikalet tjera nga ato të paraqitura në 18 01 06
- 18 01 08* Ilaçet citotoksike dhe citostatike
- 18 01 09 Ilaçet tjera nga ato të paraqitura në 18 01 08
- 18 01 10* Mbeturinat e amalgamit nga shërimi i dhëmbëve
- 18 02 Mbeturinat nga zbulimet, diagnostifikimet, trajtimet apo parandalimet e sëmundjeve përfshirë edhe kafshët
- 18 02 01 Mjetet e mprehta (përveç 18 02 02)
- 18 02 02* Mbeturina, mbledhja apo hudhja e të cilave kërkon përkujdesje të posaçme në mënyrë që të parandalohet infektimi
- 18 02 03 Mbeturina, mbledhja apo hudhja e të cilave nuk kërkon përkujdesje të posaçme në mënyrë që të parandalohet infektimi
- 18 02 05* Kemikalet që janë apo përmbajnë substanca të rrezikshme
- 18 02 06 Kemikalet tjera nga ato të paraqitura në 18 02 05
- 18 02 07* Ilaçet citotoksike dhe citostatike
- 18 02 08 Ilaçet tjera nga ato të paraqitura në 18 02 07



5. VLERËSIMI I NDIKIMIT NË MJEDIS

Mjedisi është gjithmonë i prekur nga veprimtarite e ndryshme që ushtrohen në të, por ndikimet mund të jenë të ndryshme, kjo është e lidhur ngushte me vetë llojin e veprimtarisë e cila mund të ketë impakt të drejtpërdrejtë, të terthortë, të rendësishem apo mesatar i pranueshem.

Analiza e vlerësimit të gjendjes ekzistuese të mjedisit në Impiantin për trajtimin dhe sterilizimin e mbeturinave medicinale në Prizren është një proces kompleks që kërkon një qasje të strukturuar për identifikimin dhe vlerësimin e ndikimeve negative. Kjo përfshin dy periudha kryesore:

- 1. Vlerësimi para aktivitetit punues:** Gjatë kësaj faze, ndikimet negative mund të përfshijnë ndotjen e ajrit, zhurmën, dhe ndotjen e ujërave nëntokësore. Është e rëndësishme të monitorohen emetimet e substancave të dëmshme dhe menaxhimi i mbetjeve që krijohen gjatë procesit të sterilizimit. Të dhënat duhet të mbledhen sistematikisht për të vlerësuar se si këto aktivitete ndikojnë në mjedisin përreth.
- 2. Vlerësimi pas aktivitetit punues:** Kjo fazë fokusohet në ndikimet afatgjata pas përfundimit të operacioneve. Është e domosdoshme të analizohet se si mund të ndikojnë mbeturinat e mbetura ose infrastruktura e lënë pas. Monitorimi i vazhdueshëm i cilësisë së ajrit dhe ujit, si dhe ndikimet sociale dhe shëndetësore, është thelbësor për një vlerësim të plotë.



5.1. Ndotja e ajrit

Gjatë operimit të Impiantit për trajtimin dhe sterilizimin e mbeturinave medicinale, nuk ka ndotje të ajrit nga procesi i sterilizimit, pasi ky proces realizohet pa përdorimin e kimikateve, tymit ose karbonit. Megjithatë, ndotja e ajrit mund të shkaktohet nga disa faktorë të tjerë:

- 1. Automjetet transportuese:** Ndotja e ajrit ndodh edhe nga gazrat që lirohen nga automjetet që transportojnë mbeturinat medicinale nga institucionet shëndetësore dhe ato repartet private sic janë cekur në raportet vjetore deri në Impiant. Gazrat nga djegiet motorike përmbajnë shumë



komponentë ndotës, si CO, NO_x, HxCy, SO₂ dhe Pb, të cilët kanë ndikim të dukshëm në cilësinë e ajrit.

2. **Kundërmimet:** Gjatë deponimit të mbeturinave medicinale, lirohen erëra të pakëndshme brenda objektit. Vendndodhja ku mbahen mbeturinat siç shihet ne foto nuk është adekuate e as e mirëmbajtur dhe kjo kontribon në ndotjen e ajrit dhe ne shendetin e personave te autorizuar.
3. **Gazrat nga ngrohja:** Gjatë dimrit, gazrat e lëshuar nga lëndët djegëse për ngrohjen e objektit gjithashtu kontribojnë në ndotjen e ajrit, por kjo ndotje është minimale.

5.2. Ndotja e ujit

Gjatë fazës së zhvillimit të aktiviteteve në inseneratori – impianti për trajtimin e mbetjeve spitalore, ndikimet negative në ujë ndodhin për shkak të disa faktorëve kryesorë:

Rrjedhja nga Automjetet Transportuese: Makinat transportuese të mbeturinave medicinale, gjatë transportit nga institucionet shëndetësore në Implant, mund të shkaktojnë derdhje të vajrave dhe lëndëve të tjera të dëmshme. Këto derdhje rrezikojnë të ndotin tokën dhe, si pasojë, ujërat sipërfaqësorë në rast reshjesh atmosferike. Kjo situatë nënvizon nevojën për masa të kujdesshme dhe monitorim të vazhdueshëm për të parandaluar ndotjen e mjedisit.

Grumbullimi i Mbeturinave Medicinale: Një nga problemet kryesore është se grumbullimi i mbeturinave medicinale nuk po kryhet në mënyrën e duhur. Siç tregohet në foto, thasët janë të shpuar, gjë që rrezikon derdhjen e lëndëve të dëmshme. Këto derdhje mund të ndodhin sidomos gjatë reshjeve, kur substancat e dëmshme mund të transportohen në ujërat sipërfaqësorë, duke shkaktuar ndotje të mjedisit specifikisht ujerave. Kjo situatë thekson nevojën për standarde më të larta në grumbullimin, transportin dhe ruajtjen e mbetjeve, si dhe për mbikëqyrje të rreptë për të parandaluar ndodhitë e tilla.



Figure 9. Foton nga teren – grumbullimi i mbetjeve spitalore.

Shkarkimi i Ujërave të Zeza: Pas sterilizimit, pajisja mbushet me ujë përmes rezervuarit, duke ulur temperaturën në 80°C për t'u përgatitur për hapjen e sistemit. Pas ftohjes, ujërat derdhen në kanalizim. Mbeturinat e lëngshme që rezultojnë nga proceset e trajtimit, tashmë janë streilizuar nga temperaturat shumë të larta kështuqë ky ujë njesoj si mbeturinat, nga paisja dalin te sterilizuar ne kete mënyrë duke mos ndotur token perkatësisht ujerat.



5.3. Ndotja e tokës

Toka, si një element themelor i natyrës, përbën një kusht ekologjik të domosdoshëm për rritjen e bimëve, prodhimin e ushqimit dhe ekzistencën e ekosistemeve. Ajo ndihmon në ruajtjen e balancës ekologjike duke ofruar habitat për organizmat e ndryshëm dhe duke mbështetur ciklet natyrore. Përveç kësaj, toka është thelbësore për funksione teknike, si ndërtimi i impiantit për trajtimin dhe sterilizimin e mbeturinave medicinale në Prizren, ku është e nevojshme për të siguruar një menaxhim të sigurt dhe të efektshëm të mbetjeve, duke mbrojtur kështu mjedisin dhe shëndetin publik.

Një nga ndotësit kryesorë të tokës janë substancat që shkaktohen nga rrjedhja e automjeteve gjatë transportimit të mbeturinave medicinale deri në impiant. Këto ndotje ndodhin gjithashtu gjatë grumbullimit të mbeturinave, siç është përmendur edhe në kontekstin e ndotjes së ujit. Kjo situatë nënvizon nevojën për masa të kujdesshme për menaxhimin e mbetjeve dhe mbikëqyrjen e aktiviteteve për të reduktuar ndikimet negative në tokë dhe mjedis.

5.4. Zhurma

Në domenin e mbrojtjes së mjedisit zhurma paraqet një faktor me rëndësi hapësinore e cila ka ndikim të madh në dëmtimin e të dëgjuarit, në sistemin nervor, në hipertension, në koncentrim e njeriut në punë etj.

Lokacioni i objektit është i ekspozuar zhurmës. Në kuadër të aktiviteteve në objekt nuk shkaktohet ndonjë zhurmë që do binte ndesh me ligjet në fuqi për ndotje nga zhurma, për faktin që zhurma bëhet vetem nga paisja Ecodas T300 dhe lëvizja e kamioneve për bartjen e mbeturinave. Gjatë ditës nga ora 07:00 – 19:00 niveli i zhurmës nuk do të kalojë mbi 70-75 dBA ashtu siç parashihet me Udhëzim Administrativ

Sipas gjendjes faktike mund të konstatojmë se niveli i zhurmës i shprehur është nën vlerën e lejuar dhe nuk pritet të ketë ndonjë ndikim në ngritjen e nivelit të zhurmës për mjedisin. Në kuptim me ligjin orari zgjat 12 orë dhe fillon nga ora 07:00 deri në 19:00.

5.5. Ndikimet në florë dhe faunë

Ndotjet e ajrit, ujit dhe tokës nga operimi i impiantit për trajtimin e mbeturinave medicinale kanë pasoja të rëndësishme për florën dhe faunën. Gazrat dhe substancat e dëmshme që ndoten ajrin dhe ujërat rrezikojnë shëndetin e organizmave të gjallë, duke çuar deri në reduktimin e biodiversitetit dhe dështimin e cikleve natyrore. Shkarkimi i lëndëve të dëmshme mund të ndikojnë në ushqimin dhe habitatet e faunës, ndërsa ndotja e tokës pengon rritjen e bimëve, duke rrezikuar kështu ekosistemet. Këto ndikime theksojnë nevojën për masa të menjëhershme për mbrojtjen e mjedisit dhe ruajtjen e biodiversitetit.



5.6. Ndikimi në mjedis në rastet aksidentale

Aksidentet të cilat mund të ndodhin, mund të jenë të natyrës së ndryshme dhe mund të ndodhin në çdo kohë. Aksidentet mund të ndodhin nga rrjedhjet e vajrave dhe lubrifikuesit nga impianti për sterilizimin e mbeturinave medicinale.

Aksidentet mund të ndodhin nga rrjedhjet e ndryshme të lëndëve djegëse dhe lubrifikuese nga automjetet transportuese që nevojiten për transportimin e mbeturinave medicinale nga institutet shëndetsore të komunave tjera gjër të Impianti për trajtimin - sterilizimin e mbeturinave medicinale , si dhe nga automjetet transportuese të cilat nevojiten për transportimin e mbeturinave të trajtuara gjër në deponin sanitare të mbeturinave, mundësia e pëlcitjes së gypave hidraulik, nga aksidentet e mundshme në komunikacion gjatë transportit të mbeturinave , aksidentet mund të ndodhin nga mundësia e shkaktimit të zjarrit , zjarr do të thotë çdo djegëje e pa kontrolluar që zhvillohet jashtë interesit shoqëror.

Rrezikimi i shëndetit - mundësia e infektimit të punëtorve– operatorve me impiant, gjat manipulimit me mbeturinat infektuese.



6. PËRSHKRIMI I MASAVE PËR ZVOGËLIMIN E NDIKIMEVE NEGATIVE NË MJEDIS

Sipas analizës së bërë mbi ndikimin e “**Inseneratorit – impianti për trajtimin e mbetjeve spitalore**” dhe bazuar në vlerësimin e projektit të propozuar, rezulton se paisja ECODAS T300 ka një ndikim pozitiv në mjedis. Vëllimi i mbetjeve zvogëlohet me 80%, duke eliminuar nevojën për transportin jashtë vendit të mbetjeve të rrezikshme. Kjo çon në një reduktim të kostove të trajtimit të mbetjeve, me kursime që variojnë nga 30% në 50% për shërbimet e transportit të rrezikshëm. **Materialet e trajtuara bëhen si mbetje të zakonshme komunale**, duke u bërë të përshtatshme për riciklim dhe ripërdorim të mundshëm. Për më tepër, shmangia e djegies së mbeturinave ndihmon në uljen e përgjithshme të përdorimit të energjisë dhe emetimeve të karbonit. Është e rëndësishme të theksohet se procedurat deri te lokacioni i analizuar nuk rrezikojnë mjedisin, për sa kohë që respektohen rekomandimet dhe merren të gjitha masat adekuate të përshkruara në këtë raport të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM). Këto masa kanë si qëllim parandalimin, ose së paku zvogëlimin e ndikimeve negative që mund të çojnë në rrezikimin e mjedisit jetësor. Për të zvogëluar më tej ndikimet potenciale negative, rekomandohet ndërmarrja e masave shtesë që lidhen me menaxhimin e rrezikut, si në rrethana të zakonshme ashtu edhe në situata të jashtëzakonshme.



Figure 10. Ndikimet pozitive ne mjedis nga ky proces teknologjik.



6.1. Masat për mbrojtjen e ajrit

Për mbrojtjen e ajrit gjatë operimit të Implantit për trajtimin dhe sterilizimin e mbeturinave medicinale, është thelbësore të ndërmerren disa masa kryesore.

-Së pari, ventilimi adekuat i dhomës së depozitimit të mbeturinave është i nevojshëm për të siguruar qarkullimin e ajrit dhe për të zvogëluar ndotjen nga erërat e pakëndshme, si dhe është e ndaluar që mbeturinat infektive të deponohen në dhoma ku temperatura është mbi 8°C. Kjo ndihmon në ruajtjen e cilësisë së ajrit brenda objektit dhe minimizon rreziqet për shëndetin e personelit.

-Gjithashtu, është e rëndësishme që të gjitha mbeturinat të organizohen në mënyrë të rregullt në kontinerët e përshtatshëm (si në figuren me poshte), në përputhje me standardet e menaxhimit të mbetjeve. Kjo do të ndihmojë në parandalimin e rrjedhjeve dhe ndotjes së ajrit nga substancat e dëmshme që mund të lirohen nga mbeturinat.

-Pastrimi i rregullt i depos është një masë tjetër e rëndësishme, pasi mbeturinat e papastruara mund të kontribuojnë në krijimin e erërave të pakëndshme dhe ndotjen e ajrit. Përveç këtyre masave, përdorimi i automjeteve me emisione të ulëta dhe monitorimi i vazhdueshëm i cilësisë së ajrit janë gjithashtu të domosdoshme për të reduktuar ndotjen dhe për të garantuar një ambient të sigurt për të gjithë.

Duke zbatuar këto masa, do të arrihet një mbrojtje më e efektshme e ajrit, duke kontribuar në shëndetin publik dhe mbrojtjen e mjedisit.

Pesha e vdekur përafërsisht (Kg)	14.3
Lartësia	285
Vellimi	240
Thellësia e përgjithshme (mm)	730
Lartësia e përgjithshme (mm)	1080
Gjerësia e përgjithshme (mm)	580

6.2. Masat për mbrojtjen e ujit dhe tokës

Për të parandaluar dhe zvogëluar ndikimet negative në ujë dhe tokë gjatë operimit të implantit për trajtimin dhe sterilizimin e mbeturinave medicinale, duhet të merren këto masa mbrojtëse:

1. **Edukim dhe Trajnim:** Ofrimi i trajnimeve për stafin është një hap thelbësor për menaxhimin e mbetjeve dhe mbrojtjen e mjedisit. Këto trajnime duhet të përfshijnë praktikatat më të mira për reduktimin e ndotjes, si dhe për rritjen e vetëdijes dhe përgjegjësisë për ndikimin e veprimeve të tyre në ambient.
2. **Grumbullimi i mbeturinave:** Vendosja e mbeturinave në kontejnerë të posaçëm dhe të mbyllur është një masë e rëndësishme për të parandaluar rrjedhjet dhe ndotjen. Këta kontejnerë duhet të jenë të qartë dhe të identifikuar sipas llojeve të mbetjeve, siç është parashikuar në masat për mbrojtjen e ajrit. Është thelbësore që ndarja e mbeturinave të bëhet që nga fillimi i procesit, dhe jo të besohet vetëm në punonjësit teknikë për këtë detyrë. Kjo qasje do të sigurojë një menaxhim më efikas dhe më të sigurt të mbetjeve, duke u bazuar në Ligji nr. 08/l-262 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që përmbajnë procedura të veçanta administrative dhe



harmonizimin e tyre me ligjin nr. 05/I-031 për procedurën e përgjithshme administrative faza e dytë.

3. **Monitorimi i Transportit:** Rregullimi dhe kontrolli i transportit të mbetjeve janë të domosdoshme për të minimizuar rrezikun e derdhjeve dhe ndotjes gjatë procesit. Gjatë transportit, punonjësit duhet të pajisen me rroba mbrojtëse dhe doreza të specializuara për t'u mbrojtur nga infeksionet, siç është paraqitur në figurën e mëposhtme. Për më tepër, transporti duhet të bëhet direkt në impiantin për trajtimin dhe sterilizimin e mbeturinave, duke parandaluar që ato të qëndrojnë në rrugë, siç ilustrohet në fotot e ndotjes së tokës. Kjo qasje do të sigurojë një menaxhim më të sigurt dhe më efikas të mbetjeve medicinale, duke mbrojtur shëndetin e punonjësve dhe mjedisin

Këto masa kontribuojnë në ruajtjen e ujit dhe tokës, duke mbrojtur shëndetin e ekosistemit dhe të komunitetit përreth. Nëse ke nevojë për më shumë informacion ose për përmirësime të tjera, më njofto!

6.2.1. Masat për mbrojtjen e ujit

Uji që përdoret në procesin teknologjik për trajtimin - sterilizimin e mbeturinave medicinale, nuk ka kontakt me mbeturina por aim përdoret për prodhimin e avullit dhe ftofjen e stabilimenteve të impiantit, prandaj gjatë realizimit procesin teknologjik për trajtimin - sterilizimin e mbeturinave medicinale nuk lirohen ujëra të ndotura teknologjike, por ndotja ndodh si që e kemi përshkruar ne pasuset e mësipërme, ne hapësirat punuese të objektit në të cilin është i vendosur impianti për trajtimin - sterilizimin e mbeturinave medicinale, prandaj duhet ndërtuar kolektorët – kanalet për grumbullimin dhe sistemin gypor për bartjen e ujërave të ndotura nga tëra sipërfaqet punuese të objektit në të cilin është i vendosur impianti për trajtimin - sterilizimin e mbeturinave medicinale, nga sipërfaqet ku deponohen mbeturinat medicinale, ujërat e grumbulluar nga sipërfaqet e lart cekura duhet të dërgohen për trajtim në rezervarin sedimentues për pastrimin e ujërave të ndotur me grimca të ngurta.

Për zvoglimin e temperaturës së ujit i cili del nga impianti për trajtimin - sterilizimin e mbeturinave medicinale, uji derdhet në rezervarin sedimentuese pastaj kalon në sistemin e kanalizimit.

Për të parandaluar mundësin e derdhjes të vajrave dhe lubrifikuesve nga Impianti për trajtimin - sterilizimin e mbeturinave medicinale, duhet të behët kontrollimi, mirmbajtja dhe servisimi i rregullt i impiantit për trajtimin - sterilizimin e mbeturinave medicinale.

Ujrat e zeza përmes sistemit të gypave dërgohen në sistemin e kanalizimit.

Ujërat nga impianti për trajtimin - sterilizimin e mbeturinave medicinale, nuk lejohet të lëshohen në sistemin e kanalizimit nese nuk i plotësojnë kushtet dhe vlerat e përcaktuara me Udhëzim administrativ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=58967> për kushtet, mënyrat, parametrat dhe vlerat kufizuese të shkarkimit të ujërave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe në trupin ujqor.

Furnizimi me ujë për realizimin e proceseve teknologjike për trajtimin - sterilizimin e mbeturinave medicinale, për pije si dhe për nevoja tjera sanitare, si dhe furnizimi i ujit që shfrytëzohet për larjen e platos manipuluese, për ujitje të sipërfaqeve gjelbëruese, për pajimet për zjarrfikje bëhet nga sistemi i ujësjellësit.



6.2.2. Masat e marura për mbrojtjen e tokës

Për të parandaluar dhe zvogëluar sasinë e ndikimeve negative në tokë gjatë fazës së operimit të impiantit për trajtimin - sterilizimin e mbeturinave medicinale për të parandaluar e zvogëluar sasinë e ndikimeve negative në tokë duhet marrë këto masa mbrojtëse:

- Tëra sipërfaqet ku është i vendosur impianti për trajtimin - sterilizimin mbeturinave medicinale, si dhe sipërfaqet ku deponohen mbeturinat medicinale, është mbuluar me beton dhe është izoluar me pllaka të qeramikës.
- Në të gjitha sipërfaqet ku është i vendosur impianti për trajtimin - sterilizimin e mbeturinave medicinale, si dhe në sipërfaqet në të cilat deponohen mbeturinat medicinale që mund të rezultojnë me rrjedhje eventuale duhet të bëhen ujë mbledhësit (kanalet) të cilët duhet të jenë të izoluar për mos depërtimin e tyre në tokë dhe të ketë sistem të instaluar të gypave gjer në rezervarin për sedimentimin e grimcave të ngurta eventuale dhe ftofjen e ujit të ngrohtë që del nga impianti.
- Të tëra sipërfaqet operationale jashtë objekteve ndërtuese dhe objekteve përcjellje për trajtimin e medicinale duhet të asfaltohen dhe izolojnë
- Duhet të bëhet asfaltimi dhe izolimi i sipërfaqeve të rrugëve dhe parkingut të automjeteve me qëllim që të pengohet ndotja e tokës nga derdhja eventuale e vajrave dhe derivateve nga automjetet transportuese dhe automjetet e parkuara në parking.
- Të gjitha mbeturinat që krijohen si mbetje nga trajtimi i mbeturinave medicinale të grumbullohen dhe vendosen në kontejner të posaçëm të pajisur me kapak për mbulim, duke u bazuar në Ligjin për Mbeturina Nr. 08/L-071, për ndryshimin dhe plotesimin e ligjit NR.04/L-060 për mbeturina, me transport vetanak apo nëpërmjet ndërmarrjeve për menaxhimin e mbeturinave, këto mbeturina të dërgohen në deponin e mbeturinave sanitare - regjionale.
- Duhet të bëhet mbjellja e sipërfaqeve dhe oazave të pa betonuara dhe asfaltuara me barë dhe drunjtë dekorativ me qëllim të pastrimit të ajrit nga ndotjet me erëra kundërmuese dhe për çështje vizuale.
- Duhet të tërë oborri i objektit të thuret me rrethoj fizike në lartësi minimale 2.5 metra, për mënyrë që cilës nuk mund të shihet nga jashtë, si dhe brenda rrethojës fizike të krijohet muri prej drunjesh dekorativ.
- Rrethoja fizike e objektit, nga aspekti vizuel nuk duhet të ketë pamje të vrazhdë nga jashtë, por duhet të jetë e integruar me mjedisin - peisazhin e rrethinës.

6.3. Masat që duhet të meren në raste aksidenti

- Për zvogëlimin e mundësisë të infektimit të puntorëve gjatë manipulimit me mbeturina medicinale, puntori duhet të pajiset dhe mban rrobat mbrojtëse, dorezat kundër infeksionit.
- Për të parandaluar mundësinë e derdhjes të vajrave dhe lubrifikuesve nga Impianti për trajtimin - sterilizimin e mbeturinave medicinale, duhet të bëhet kontrollimi, mirëmbajtja dhe dhe servisi i rregullt i impiantit për trajtimin - sterilizimin e mbeturinave medicinale.



- Për shuarjen e zjarrit të përdoren aparatet mobile zjarrfikëse që duhet të vendosen në vendet ku do të jenë më efikas psh. në hapësirat ku mbahen mbeturinat medicinale etj. Zakonisht vendosen dy aparate mobile zjarrfikëse të tipit (S9) dhe një arkë me rërë.
- Duhet të ndërtohet sistemi i pajisjeve kundër zjarrit me anë të ujit dhe të sigurohen aparatet me mjete kimike si dhe enët me rërë.
- Në rastet kur kemi rrjedhje të vajrave dhe derivateve, atëherë lëngu i derdhur duhet të pastrohet me absorbues kimik apo me ashkla të imta druri të cilat me lopata mblidhen dhe futen në fuqi ku mbahen në depo deri sa të merën nga kompanitë e licencuara për trajtimin e tyre.

6.4. Rekomandimet tjera për evitimin e ndikimeve negative

- Të bëhet mbikëqyrje e rregullt dhe menaxhim sa më i mirë gjatë trajtimit - sterilizimit të mbeturinave medicinale.
- Ndalohet magazinimi i mbeturinave medicinale në mënyrë të pakontrolluar në hapësirat e objektit në të cilin është i vendosur impianti për trajtimin - sterilizimin e mbeturinave medicinale që nuk janë të dedikuara për deponimin magazinimin e tyre.
- Magazinimi i mbeturinave infektive dhe mjeteve të mprehta infektive, duhet të bahet në hapësirat ku ekzistojnë kushtet e klimatizimit, në kohëzgjatje vetëm për 1 (një) ditë.
- Është e ndaluar që mbeturinat infektive të magazinohen në kushtet me temperatur mbi 8°C.
- Ndalohet deponimi – vendosja e mbeturinave medicinale të sterilizuara në mënyrë të pakontrolluar në hapësirat e objektit dhe për rreth tij, deponimi - vendosja e ktyre mbeturinave të sterilizuara të bëhet në kontejner të dedikuar për deponimin e tyre.
- Në impiantin për sterilizimin e mbeturinave medicinale Rreptësisht ndalohet hedhja e:
 - Plancetave,
 - Medikamenteve të ndryshme (Ampula, Tableta, Supposte, etj.)
 - Mbetjet organike nga sallat e operacionit (kirurgjisë, Gjinekologjisë, Urologjisë, etj.),
 - Rrobave të ndryshme, Manteleve, Çarçafëve, etj.
 - Mbeturinat e forta (Hekur, etj.),
- Operatori është i detyruar të mbanë evidencën dhe ruan shënimet për sasinë e mbeturinave medicinale të pranuar nga institucionet shëndetsore, dhe emrin e institucioneve shëndetsore nga e cila i ka pranuar, të mbaj shënimet për sasinë e mbeturinave medicinale të cilat trajtohen- sterilizohen, si dhe të ruaj rexhistrin – të dhanat me parametrat gjat realizimit të procesit të trajtimit- sterilizimit.
- Pronari është i detyruar të mbanë evidencën dhe ruan shënimet për dërgimin e mbeturinave të trajtuara – sterilizuara në deponin e mbeturinave sanitare.
- Evidenca dhe shënimet duhet të mbahen sipas rekomandimeve që jepen ne Ligjin për Mbeturina Nr. 08/L-071, për ndryshimin dhe plotesimin e ligjit NR.04/L-060 për mbeturina dhe Udhëzimeve administrative për mbeturina relevante të hartuara sipas rekomandimeve nga LIGJI NR. 08/L-071 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR.04/L-060 PËR MBETURINA.



- Të hartohet rregullorja ku do të definohen procedurat për rastet aksidentale, të bëhet aftësimi i të punësuarve dhe të caktohen obligimet e tyre në situata aksidentale.
- Në mënyrë permamanente të mirëmbahet ambienti afër objektit për trajtimin – sterilizimin e mbeturinave medicinale.



7. MARJA E MASAVE REHABILITUESE PAS PËRFUNDIMIT TË PROJEKTIT

Pas përfundimit të jetë gjatësisë së objektit për trajtimin – sterilizimin e mbeturinave medicinale, kjo varet nga përfaqshuesit e spitalit të përgjithshëm se sa do të vazhdoj me këtë projekt si dhe jetëgjatësisë së impiantit, pas skadimit të jetëgjatësisë të impiantit përfaqshuesit e spitalit të përgjithshëm vendosin të blejnë pajisje – impiant tjetër ose kthejnë objektin ta përdorin për qëllime tjera.

Nëse vendosin ta rrënojnë objektin atëherë bazamentet si dhe platot nga betoni duhet të shkatërrohen, imtësohen dhe të dërgohen në deponi regjionale.

Të gjitha mbetjet e mbeturinave të ngurta dhe ato të inerteve që ekzistojnë në sipërfaqet e lokacionit si shtresa e dheut të kontaminuar pa tjetër duhet të largohen dhe të bëhet zëvendësimi, me një shtresë të humusit prej 0,5m trashësi të analizuar nga aspekti agrokimik, pastaj duhet të bëhet ngjeshja e kësaj shtrese të humusit (dheut) me qëllim që të jetë shtresa më kompakte, ashtu që të krijohet një substrat produktiv i përshtatshëm për rikultivim.

Rikultivimi i këtyre sipërfaqeve të dëmtuara përfshin rivitalizimin në tërësi të hapësirave të dëmtuara nga realizimi i projektit. Zgjedhja e modelit të rikultivimit varet nga: Qëllimi i rikultivimit i cili nënkupton sipërfaqeve të degraduara, prapë të kthehet funksioni i saj primar (prodhimi i biomasës), të kthehet në gjendje të përafërt me ambientin rrethues, dhe të mbjellën barë dhe bimë dekorative të cilat kultivohen në rrethinë të lokalitetit, dhe kështu zvogëlohet ndikimi negativ i këtij projekti në ekosistem.



8. PËRFUNDIM

Hulumtimi, të gjeturat, informatat, të dhenat, matjet dhe shenimet janë perpunura në menyrë të detajuar nga të cilat rezultojnë dhe përfundimet e këtij raporti të VNM-së. Marr parasysh të gjithë parametrat e procesit të punës në impiantin për trajtimin dhe sterilizimin e mbetjeve spitalore, si dhe duke zbatuar rekomandimet dhe masat e përshkruara në këtë raport të VNM-së, konkludojmë se ekzistimi dhe funksionimi i këtij impianti nuk shkakton ndikime negative në mjedis dhe nuk rrezikon shëndetin e njeriut.

Përkundrazi, ky projekt ofron ndikime pozitive, duke minimizuar rrezikun për shëndetin dhe mjedisin nga mbeturinat medicinale, dhe është një teknologji e gjelbër, miqësore me mjedisin. Inserterori - Impianti nuk emeton substanca të rrezikshme si tymi, elemente kimikë apo rrezatim, duke ulur gjithashtu kostot e trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave infektive. Duke përdorur vetëm avull dhe energji elektrike për trajtimin e mbeturinave shumë infektive në vend, impianti shmang lëshimin e substancave të dëmshme.

Duke marrë parasysh llojin dhe kapacitetin e projektit, nuk ka potencial për të rrezikuar shëndetin e njerëzve, ashtu si ndikimet në tokë, ujë, ajër dhe peizazh. Pas identifikimit dhe zbatimit të të gjitha masave mbrojtëse të rekomanduara, konstatojmë ndotjet do të jenë brenda kufijve të lejuara nga legjislacioni në fuqi. Në këtë kontekst, besojmë se të dhënat e paraqitura janë të mjaftueshme për të mundësuar MMPHI-në që të japë mendimin për pëlqim mjedisor për impiantin për trajtimin dhe sterilizimin e mbeturinave medicinale në Prizren, sipas kërkesës të Spitalit Regjional – Prizren

Aplikuesi:

Spitali i Përgjithshëm "Prim.Dr.DAUT MUSTAFA" – Prizren

Azem Krasniqi

Perpiluesi i raportit:

Masar Kabashi Msc. ark. Licencuar me VNM

Shtator, 2025



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit
Ministarstvo Ekonomije i Zivotne Sredine
Ministry of Economy and Environment



Në bazë të nenit 16 paragrafit 1 të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr.03L/214 dhe Udhëzimit Administrativ për Licencim të Hartuesëve të Raporteve për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr.10/2017, Ministri i MEA lëshon:

Nr. i licencës: 57/17

LICENCË

z. Masar Kabashi, Inxhinier i Diplomuar i Arkitekturës

Licencohet si person fizik për hartimin e raporteve të VNM-ës

Data e vlefshmërisë:
19.06.2020— 19.06.2025
Prishtinë

